

UDHËZIM
Nr.26, datë 04.09.2008

PËR TAKSAT KOMBËTARE
I NDRYSHUAR

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit Nr.9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombetare, Ministri i Financave:

U D H Ë Z O N:

1.Dispozita të Përgjithshme

1.1. Në zbatim të nenit 6 të ligjit Nr.9975, datë 28.07.2008, taksat kombëtare derdhen 100% në buxhetin e shtetit. Taksat vjetore, arkëtohen nga agjentët e taksave dhe transferohen në buxhetin e shtetit brenda datës 30 të majit kur janë arkëtuar taksat.

Kur detyrimi për pagimin e taksave lind në gjashtëmujorin e parë të vitit, taksat paguhen në masën 100%, ndërsa kur detyrimi lind për herë të parë në 6/mujorin e dytë, taksat paguhen në masën 50 përqind të shumës së taksës vjetore të përcaktuar në ligj.

1.2. Në zbatim të nenit 5 të ligjit agjentët e taksave janë të detyruar të bëjnë vjeljen e taksave dhe të derdhin në buxhet shumat e vjela sipas ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

1.3. Në zbatim të nenit 8, agjentët e taksave të përcaktuar në nenin 5 të ligjit, përfitojnë një përqindje të caktuar të arkëtimeve nga taksat. Punonjësit e taksave në Drejtoritë Rajonale të Tatimeve bëjnë akt rakordime me agjentët e taksave për taksat e vjela, si dhe përcaktojnë shumën që u takon agjentëve të taksave. Aktin e rakordimit, i cili do të jetë i firmosur nga inspektori i taksave, përfaqësuesi i agjentit të taksave si dhe nga Kryetari i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, agjentët e taksave duhet ta paraqesin në degën e thesarit të rrethit ku ushtrojnë aktivitetin e vjeljes së taksave. Modeli i Aktit të Rakordimit dhe përmbajtja e tij do të jetë sipas formularit Nr. 1 bashkëngjitur këtij udhëzimi. Kriteret e përdorimit të komisioneve që ju jepen agjentëve të taksave janë përcaktuar në ligj dhe akte nënligjore dhe përdoren:

- a) në formën e shpërblimit mbi pagën, për vështirësi në punë, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;
- b) në formën e pagës, për rastet kur merren punonjës të rinj, për përballimin e vjeljes së taksave;
- c) për mekanizimin, informatizimin, përmirësimin e kushteve të punës, si dhe përballimin e shpenzimeve për vjeljen e taksave.

2.Dispozita të Veçanta

Sipas llojit të taksave, kemi keto lloje taksash:

2.1. Taksat portuale

Taksat portuale paguhen nga anijet shqiptare ose të huaja sa herë prekin portet e Republikës së Shqipërisë. Masa e kësaj takse është 1 Euro. Taksat portuale paguhen me mbërritjen e anijes në port, dhe janë të vlefshme për të gjithë kohën që anija qëndron në port.

Ngarkohen me vjeljen e këtyre taksave kapiteneria e porteve, e cila i vjel këto taksa drejtpërdrejt ose nëpërmjet agjensive detare shtetërore ose private.

Në kuptimin e ligjit, nëse anija për kryerjen e veprimeve të saj do të prekë edhe një port tjetër shqiptar, paguan vetëm në portin e parë. Pra, nëse një anije mbërrin në Durrës dhe shkarkon një pjesë të mallit dhe në të njëjtin rejs shkarkon pjesën tjetër në Shëngjin atëherë kjo anije paguan vetëm në portin e parë. Në qoftëse një anije që vjen nga një port i huaj shkarkon në portin e Durrësit ku paguan taksat portuale dhe ngarkon në këtë port një mall të ri të cilin e shkarkon në një port tjetër shqiptar si p.sh. në Vlorë, atëherë kjo anije do të paguajë taksat portuale edhe në portin e Vlorës.

Taksat portuale paguhen në secilin port të Shqipërisë, pavarësisht nëse anija mbërrin nga jashtë ose nga një port tjetër i shtetit shqiptar. Anije të subjekteve shqiptare do të konsiderohen anijet që janë në pronësi të vet dhe anijet e marra me qera.

2.2. Taksa e qarkullimit për benzinën dhe gazoilin

Taksa e qarkullimit për benzinën aplikohet për produktet sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59 dhe për gazoilin, sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49. Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin është 5 lekë litri deri në 31.12.2011, pas kësaj date, taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazoilin bëhet 7 lekë litri. Kjo taksë zbatohet si për benzinën e gazoilin e importuar, ashtu edhe për atë të prodhuar në vend.

Për benzinën dhe gazoilin e importuar, importuesi e paguan taksën e qarkullimit pranë degëve doganore ku është duke kryer procedurat e zhdoganimit.

Për benzinën dhe gazoilin e prodhuar, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e prodhuar, brenda dates 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.1, si bashkëlidhur, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatapagesën për taksën e paguar.

2.3. SHFUQIZOHET

2.3.1. Taksa e mjeteve të përdorura të transportit caktohet sipas formulës:

Cilindrata në cm^3 x koeficienti fikse sipas vjetërsisë x taksa fikse për llojin e karburantit.

Taksa fikse për llojin e karburantit është 25 lekë për naftën dhe 20 lekë për benzinën. Koeficienti sipas vjetërsisë së mjetit është si në shtojcën 1 bashkëlidhur këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij. Mjetet me vjetërsi nga 0-3 vjet nuk janë subjekt i kësaj takse. “Viti i vjetërsisë” është diferenca ndërmjet vitit, kur mjeti kryen pagesën e taksës me vitin e prodhimit.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Për mjetet, që regjistrohen për herë të parë, taksa llogaritet proporcionalisht për periudhën e mbetur të vitit. 18% e të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalojnë buxhetit të

DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE – LEGJISLACIONI TATIMOR 2011
 Udhezim Nr. 26, date 04.09.2008

qeverisjes vendore në bazë të procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Paguesa e taksës bëhet në çdo kohë, por gjithnjë para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Vlera e taksës është vjetore (për vitin kalendarik në të cilin arkëtohet)
 pavarësisht nga momenti në të cilin ajo paguhet.

Shembuj:

Tabela e mëposhtme përmbledh masën e taksës që paguan një automjet, në bazë të cilindrates, vitit të vjetërsisë dhe llojit të karburantit që përdor, naftë apo benzinë.

Automjetur																
Naftë																
viti vjetërsisë/cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
1200	5,400	5,700	6,000	6,300	6,600	6,900	7,200	7,500	7,800	8,100	8,400	8,700	9,000	9,300	9,600	9,900
1300	5,850	6,175	6,500	6,825	7,150	7,475	7,800	8,125	8,450	8,775	9,100	9,425	9,750	10,075	10,400	10,725
1400	6,300	6,650	7,000	7,350	7,700	8,050	8,400	8,750	9,100	9,450	9,800	10,150	10,500	10,850	11,200	11,550
1500	6,750	7,125	7,500	7,875	8,250	8,625	9,000	9,375	9,750	10,125	10,500	10,875	11,250	11,625	12,000	12,375
1600	7,200	7,600	8,000	8,400	8,800	9,200	9,600	10,000	10,400	10,800	11,200	11,600	12,000	12,400	12,800	13,200
1700	7,650	8,075	8,500	8,925	9,350	9,775	10,200	10,625	11,050	11,475	11,900	12,325	12,750	13,175	13,600	14,025
1800	8,100	8,550	9,000	9,450	9,900	10,350	10,800	11,250	11,700	12,150	12,600	13,050	13,500	13,950	14,400	14,850
1900	8,550	9,025	9,500	9,975	10,450	10,925	11,400	11,875	12,350	12,825	13,300	13,775	14,250	14,725	15,200	15,675
2000	9,000	9,500	10,000	10,500	11,000	11,500	12,000	12,500	13,000	13,500	14,000	14,500	15,000	15,500	16,000	16,500
2100	9,450	9,975	10,500	11,025	11,550	12,075	12,600	13,125	13,650	14,175	14,700	15,225	15,750	16,275	16,800	17,325
2200	9,900	10,450	11,000	11,550	12,100	12,650	13,200	13,750	14,300	14,850	15,400	15,950	16,500	17,050	17,600	18,150
2300	10,350	10,925	11,500	12,075	12,650	13,225	13,800	14,375	14,950	15,525	16,100	16,675	17,250	17,825	18,400	18,975
2400	10,800	11,400	12,000	12,600	13,200	13,800	14,400	15,000	15,600	16,200	16,800	17,400	18,000	18,600	19,200	19,800
2500	11,250	11,875	12,500	13,125	13,750	14,375	15,000	15,625	16,250	16,875	17,500	18,125	18,750	19,375	20,000	20,625
2600	11,700	12,350	13,000	13,650	14,300	14,950	15,600	16,250	16,900	17,550	18,200	18,850	19,500	20,150	20,800	21,450
2700	12,150	12,825	13,500	14,175	14,850	15,525	16,200	16,875	17,550	18,225	18,900	19,575	20,250	20,925	21,600	22,275
2800	12,600	13,300	14,000	14,700	15,400	16,100	16,800	17,500	18,200	18,900	19,600	20,300	21,000	21,700	22,400	23,100

Benzinë																
viti vjetërsisë/cilindrata	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19
1200	4,320	4,560	4,800	5,040	5,280	5,520	5,760	6,000	6,240	6,480	6,720	6,960	7,200	7,440	7,680	7,920
1300	4,680	4,940	5,200	5,460	5,720	5,980	6,240	6,500	6,760	7,020	7,280	7,540	7,800	8,060	8,320	8,580
1400	5,040	5,320	5,600	5,880	6,160	6,440	6,720	7,000	7,280	7,560	7,840	8,120	8,400	8,680	8,960	9,240
1500	5,400	5,700	6,000	6,300	6,600	6,900	7,200	7,500	7,800	8,100	8,400	8,700	9,000	9,300	9,600	9,900
1600	5,760	6,080	6,400	6,720	7,040	7,360	7,680	8,000	8,320	8,640	8,960	9,280	9,600	9,920	10,240	10,560
1700	6,120	6,460	6,800	7,140	7,480	7,820	8,160	8,500	8,840	9,180	9,520	9,860	10,200	10,540	10,880	11,220
1800	6,480	6,840	7,200	7,560	7,920	8,280	8,640	9,000	9,360	9,720	10,080	10,440	10,800	11,160	11,520	11,880
1900	6,840	7,220	7,600	7,980	8,360	8,740	9,120	9,500	9,880	10,260	10,640	11,020	11,400	11,780	12,160	12,540
2000	7,200	7,600	8,000	8,400	8,800	9,200	9,600	10,000	10,400	10,800	11,200	11,600	12,000	12,400	12,800	13,200
2100	7,560	7,980	8,400	8,820	9,240	9,660	10,080	10,500	10,920	11,340	11,760	12,180	12,600	13,020	13,440	13,860
2200	7,920	8,360	8,800	9,240	9,680	10,120	10,560	11,000	11,440	11,880	12,320	12,760	13,200	13,640	14,080	14,520
2300	8,280	8,740	9,200	9,660	10,120	10,580	11,040	11,500	11,960	12,420	12,880	13,340	13,800	14,260	14,720	15,180
2400	8,640	9,120	9,600	10,080	10,560	11,040	11,520	12,000	12,480	12,960	13,440	13,920	14,400	14,880	15,360	15,840
2500	9,000	9,500	10,000	10,500	11,000	11,500	12,000	12,500	13,000	13,500	14,000	14,500	15,000	15,500	16,000	16,500
2600	9,360	9,880	10,400	10,920	11,440	11,960	12,480	13,000	13,520	14,040	14,560	15,080	15,600	16,120	16,640	17,160
2700	9,720	10,260	10,800	11,340	11,880	12,420	12,960	13,500	14,040	14,580	15,120	15,660	16,200	16,740	17,280	17,820
2800	10,080	10,640	11,200	11,760	12,320	12,880	13,440	14,000	14,560	15,120	15,680	16,240	16,800	17,360	17,920	18,480

Shënim: Në bazë të shtojcës nr 1 të Ligjit nr. 10 458, datë 29. 07. 2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, pas vitit të 24-et të përdorimit, për autoveturat, koeficienti rritet me 0.04.

Mjetet që regjistrohen për herë të parë, në momentin e targimit të tyre, paguajnë vlerën e taksës në raport me kohën e hyrjes në qarkullim në territorin e Shqipërisë. Në rast se mjeti targohet në muajin janar, taksa paguhet e plotë, ndërsa për periudhën në vazhdim taksa paguhet në raport me muajt e hyrjes në qarkullim, pavarësisht datës së muajit.

Në rast se një mjet targohet për herë të parë pas muajit janar, vlera e taksës së mjeteve të përdorura është e barabartë me vlerën e taksës sipas formulës, pjesëtuar me 12 dhe shumëzuar me numrin e muajve të mbetur nga viti kalendar, që janë muajt në përdorim.

Shembull. Në rast se një autoveturë me cilindrata 2100 cm³, që punon me benzinë, me vite vjetërsie 11 vite, targohet për herë të parë në muajin maj, vlera e taksës së mjeteve të përdorura është e barabartë me vlerën e taksës sipas formulës, pjesëtuar me 12 dhe shumëzuar me 8 që janë muajt në përdorim.

Taksa e mjeteve të përdorura është: $2100 \times 20 \times 0.28 = 11,760$ lekë. Mjeti do të përdoret për 8 muajt e mbetur të vitit. Për këtë arsye, pronari i mjetit do të paguajë taksën në shumën $(11760/12)$

$*8 = 7,840$ lekë.

Pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë dhe me pullën e taksës. Zotëruesi i mjetit e vendos pullën e taksës në xhamin e përparmë të mjetit për të lehtësuar ushtrimin e kontrollit visual nga organet kompetente. Këto dokumente prodhohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja “c” të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar. Dokumentet e mësipërme duhet të përmbajnë elemente të sigurisë së lartë, për të shmangur falsifikimin e tyre. drejtoritë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor bëjnë regjistrimin ditor të arkëtimit të taksës, që shërben si dokument bazë për rakordimin e pagesës së taksës me organet e tatimeve. Regjistrimi bëhet në një regjistër të veçantë ose në mënyrë elektronike, forma dhe përmbajtja e të cilit janë sipas formularit nr.2, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Këto drejtori, Brenda datës 31 janar të çdo viti, dërgojnë në drejtoritë rajonale të tatimeve dhe në strukturat e Ministrisë së Brendshme listën e mjeteve që nuk kanë paguar taksën për vitin paraardhës, si dhe listën e mjeteve të regjistruara. Personat fizikë apo juridikë, pronarë të këtyre mjeteve, në këto lista do të trajtohen si debitorë dhe nga ana e DPSHTRR-së dhe ndaj tyre do të fillojë të zbatohen masat shtrënguese.

Në rastet e mjeteve të cilat ndërrojnë pronësinë, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së nuk procedojnë me regjistrimin e pronësisë së mjetit në rast se për atë mjet nuk janë paguar taksat respektive.

Për mjetet që dalin përfundimisht nga qarkullimi, në momentin e paraqitjes së qytetarit për çregjistrimin e përhershëm, llogaritja për vlerën e taksës do të jetë e barabartë në raport me periudhën, që mjeti ka qenë në qarkullim.

Pas datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr.10 458, datë 29.7.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, të gjitha mjetet që për vitin 2011 nuk kanë paguar taksën vjetore të qarkullimit dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm, do të paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura, pavarësisht kur e kanë pasur datën e pagesës së taksave.

Vetëm për vitin 2011, mjetet që do të paguajnë taksën vjetore të mjeteve të përdorura do të pajisen me pullën e taksës së qarkullimit, aktualisht në përdorim nga DPSHTRR-ja.

2.3.2. Taksa e karbonit për benzinën, benzolin dhe gazoilin

Taksa e karbonit aplikohet për benzinën (sipas kodeve tarifore të NKM-së 2710 11 41, 2710 11 45, 2710 11 49, 2710 11 51, 2710 11 59), për gazoilin (sipas kodeve tarifore 2710 19 31, 2710 19 35, 2710 19 41, 2710 19 45, 2710 19 49), për qymyrin, me krerë tariforë të NKM-së 2701 dhe 2702, për vajgurin sipas kodeve tarifore (sipas kodeve tarifore 27 10 19 11 deri 27 10 19 29), për solarin (sipas kodit tarifor 2710 19 61), për mazutin (sipas kodeve tarifore të NKM 27101963, 27101965 dhe 27101969) dhe për koks nafte (sipas krerëve tariforë të NKM 2713 11 00 dhe 2713 12 00).

Taksa e karbonit caktohet në masën 1.5 lekë për litër për benzinën, 3 lekë për litër për gazoilin, 3 lekë për kilogramë për qymyrin, 3 lekë për litër për solarin, 3 lekë/litri për mazutin, 3 lekë për litër për vajgurin dhe 3 lekë për kilogramë për koks nafte. Kjo taksë zbatohet si për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks nafte e importuar, ashtu edhe për ato të prodhuara në vend.

Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks nafte e importuar, importuesi në momentin e importimit paguan taksën e karbonit, pranë degëve doganore ku kryhen procedurat e zhdoganimit.

Për benzinën, gazoilin, qymyrin, vajgurin, solarin, mazutin dhe koks nafte e prodhuar, prodhuesit llogaritin dhe deklarojnë detyrimin për taksën e karbonit në degën përkatëse të tatimeve në bazë të sasive të prodhuara të këtyre produkteve. Shumat e paguara nga kjo taksë derdhen Brenda datës 5 të muajit pasardhës në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku subjekti është regjistruar. Prodhuesi duhet të plotësojë e dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.3, si bashkëlidhur, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke I bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.

Pika 2.3.3 shfuqizohet.

2.4. Taksa e rentës minerare

Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar. Këshilli i Ministrave përcakton procedurat e arkëtimit së rentës minerare dhe dokumentacionin që duhet të paraqesë i licencuari, eksportuesi, për të vërtetuar çmimin e shitjes.

2.4.1 Taksa e rentës minerare përcaktohet në pikën 4 të nenit 4 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave, në zbatim të tij.

Vlera e saktë, në përqindje, e rentës së pasurisë minerare, sipas vlerës së tregut, për çdo mineral apo grup mineralesh, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit, 15-ditshin e parë të muajit shkurt të çdo viti.

Subjektet, zotëruese të lejes së shfrytëzimit të mineraleve, brenda datës 15 të muajit pasardhës, duhet të derdhin për llogari të degës së tatimeve ku ushtrojnë aktivitetin, taksën e rentës së pasurisë minerare, sipas llojit të mineralit të prodhuar (nxjerrë), sipas specifikimeve të shtojcës nr.2 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare", si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të tij.

Kur subjekti eksporton specifikisht mineralet, sipas emërtimeve të shtojcës nr.2 të ligjit "Për taksat kombëtare" apo nënprodukte minerare (koncentrat minerali dhe

produkte metalurgjike), renta minerare do të aplikohet në doganë, në momentin kur bëhet deklarata e eksportit.

Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dërgon në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave listën me normativat korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve minerare.

Lista e normativave korresponduese të mineraleve të përdorura për prodhimin e nënprodukteve, duhet të publikohet edhe në website-n e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Për të gjitha nënproduktet minerare, për të cilat ka normativa të përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, organet doganore dhe tatimore do t'u referohen këtyre normativave, për përcaktimin e vlerës mbi të cilën do të llogaritet renta minerare.

a) Nëse mineralet apo nënproduktet e tyre (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) destinohen për konsum final në tregun e brendshëm, renta minerare paguhet për llogari të degëve tatimore nga subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit të mineralit. Baza e taksueshme, mbi të cilën aplikohet renta minerare, është vlera e deklaruar në faturën e shitjes së mineralit nga shitësi për mineralet dhe vlera e prodhimit (nxjerrjes) të mineralit të përdorur për prodhimin e nënprodukteve, sipas normativave korresponduese për nënproduktet (për ato nënprodukte që ka normativa të përcaktuara, sipas shembullit 1 më poshtë).

b) Kur subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit është edhe eksportues minerali apo nënprodukti të tij (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike), renta minerare për sasinë e eksportuar paguhet në degët doganore në momentin e bërjes së deklaratës doganore të eksportit. Pagesa e kësaj takse, në rastin e eksportit, evidentohet me mandatar-këtimin ose në deklaratën doganore të eksportit. Baza e taksueshme, mbi të cilën do të aplikohet renta minerare, është si më poshtë:

- për eksportin e mineraleve të specifikuar në shtojcën nr.2 të ligjit, vlera e faturës së shitjes së mineraleve.

- për eksportin e nënprodukteve (koncentrat minerali dhe prodhime metalurgjike) për të cilat ka normativa korresponduese, vlera e kostos së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit të përdorur për këto nënprodukte. Kjo vlerë përcaktohet bazuar në sasinë e produktit përfundimtar (koncentrat apo prodhime metalurgjike), të deklaruar në doganë, si dhe normativat dhe kostot korresponduese të mineralit të përdorur, të dërguara nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, sipas shembullit të mëposhtëm:

Shembull 1. Subjekti X po eksporton një sasi 100 tonë prodhim ferrokromi nga miniera e Bulqizës, mesatarisht 39%, Cr₂O₃. Supozojmë se normativat korresponduese janë respektivisht, për 1 ton ferrokrom FeCr nevojiten 2,75 tonë mineral Cr₂O₃ dhe kostoja e 1 ton lënde të parë (minerali) është 75 usd/tonë. Në këtë rast, përkatësisht për sasinë prej 100 tonësh ferrokrom të eksportuar janë përdoruar $(100 \times 2.75) = 275$ tonë mineral $\times 75 \text{ usd/ton} = 20.625 \text{ USD}$, pra 20.625 USD është vlera mbi të cilin do të aplikohet përqindja e rentës minerare në doganë, e konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të cilin aplikon dogana ditën e kryerjes së transaksionit.

c) Kur eksporti i mineralit apo nënprodukteve (koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike) kryhet nga subjekte të cilat janë vetëm eksportuese dhe jo shfrytëzuese të mineralit (e blejnë mineralin apo nënproduktet nga një subjekt tjetër me faturë tatimore), organet doganore do të aplikojnë rentën minerare në doganë, bazuar në faturat e blerjes së mineralit apo nënproduktit të tij. Në këtë rast,

subjekteve eksportuese u rimbursohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë. Rimbursimi kryhet nga organet tatimore, brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga subjekti. Dokumentacioni justifikues që subjekti duhet të depozitojë te degët e tatimeve për të marrë rimbursimin është:

1. Kopje e mandatarekëtimit të lëshuar nga dogana ose kopje e deklaratës doganore të eksportit, ku pasqyrohet vlera e rentës minerare të paguar në doganë (paraqitja vetëm e njërit prej dokumenteve është i mjaftueshëm).

2. Kopje e faturës tatimore të blerjes së mineralit nga subjekti shitës.

3. Kopje e kontratës së shitjes, të lidhur ndërmjet subjektit blerës/eksportues dhe shitësit të mineralit, koncentratit të mineralit apo prodhimeve metalurgjike.

d) Kur subjekti eksporton koncentrat minerali apo prodhime metalurgjike të prodhuara tërësisht ose pjesërisht me mineral importi, renta minerare do të aplikohet në doganë, vetëm për pjesën e mineralit të përdorur për këtë sasi eksporti, mineral i cili është blerë apo prodhuar në vend. Për pjesën e mineralit të importuar, subjekti do të depozitojë pranë degës doganore, kopjen e deklaratës doganore të importit (dy kopje), në të cilat punonjësi i doganës do të pasqyrojë sasinë e mineralit të importit, të mbetur gjendje te subjekti (nëse mbetet sasi gjendjeje) me firmën dhe vulën e doganës. Një kopje e dokumentit mbahet nga dega e doganës dhe një i kthehet subjektit për ta paraqitur në doganë, kur bëhet eksporti i radhës.

2.4.2 Për sektorin hidrokarbur, çmimi i naftës bruto mbi të cilin do të aplikohet renta minerare do të miratohet nga komisioni ad-hoc, krijuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005. Ministria e Financave, pas miratimit do të dërgojë për zbatim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Çmimi i naftës bruto i vlerësuar në \$/fuçi, do të llogaritet me formulë të posaçme, dhe do të miratohet nga komisioni i krijuar sipas pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008. Ky komision do të përdorë për llogaritjen e çmimit të naftës bruto, të dhënat e nxjerra nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) ku do të merren në konsideratë cilësia e naftës bruto, graviteti i naftës bruto, përmbajtja e squfurit, përmbajtja e ujit, përmbajtja e mbetjeve, përmbajtja e fraksioneve të naftës, si dhe elemente të tjera përbërëse.

2.4.3 Për të gjitha kategoritë e tjera të nënprodukteve minerare, të cilat mund të derivojnë nga mineralet e specifikuar në aneksin nr.1 të ligjit "Për taksat kombëtare" dhe vendimin e Këshillit të Ministrave në zbatim të saj (siç mund të jenë p.sh. nënproduktet e çimentos, argjilës, naftës etj.) dhe për të cilat nuk ka normativa korresponduese të mineraleve, të përcaktuara nga METE, kur zotëruesi i lejes së shfrytëzimit është njëkohësisht edhe përpunues, renta minerare do të aplikohet mbi vlerën e koston së prodhimit (nxjerrjes) së mineralit, kosto e cila deklarohet nga prodhuesi dhe paguhet pranë organeve tatimore, sipas procedurave të mëposhtme:

a) Kur produkti është mineral i nxjerrë nga miniera dhe i shitur brenda vendit, vlera që do të merret parasysh për aplikimin e rentës është çmimi i shitjes së produktit.

b) Në rastin kur produkti përfundimtar i shitur është përpunuar më tej, vlera e mineralit është e barabartë me çmimin e shitjes së produktit përfundimtar gjatë muajit kalendarik minus:

- shpenzimet e pasurimit, shkrirjes dhe të rafinimit, që janë kryer mbi mineralin;
- shpenzimet e transportit nga miniera në fabrikën e pasurimit, shkritore ose impiantet e rafinimit të mineralit;

- të gjitha shpenzimet e tjera, të cilat nuk janë zbritur dhe që lidhen me koston e pasurimit, shkrirjes ose rafinimit.

2. Çmimi i shitjes nënkupton:

a) Në qoftë se produkti eksportohet, çmimi i shitjes është F.O.B. Shqipëri.

b) Në qoftë se produkti nuk eksportohet, çmimi i shitjes është i barabartë me çmimin e shitjes brenda vendit minus:

- shpenzimet e transportit të produktit nga pika e prodhimit deri në pikën e shitjes F.O.B Shqipëri;

- shpenzimet e tjera të shitjes, nëse ka të tilla.

Zotëruesi i lejes dorëzon brenda datës 5 të çdo muaji formularin tip nr.5, bashkëngjitur këtij udhëzimi. Ai duhet të japë gjithashtu, kur është e nevojshme, edhe të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe përshkrimin e mineralit;

b) emrin dhe adresën e zotëruesit të lejes dhe administratorit;

c) sasinë e mineralit të prodhuar gjatë muajit të kaluar;

d) një konfirmim lidhur me prodhimin e muajit të kaluar dhe shpërndarjen e tij (p.sh. te konsumatorët, fabrikat e pasurimit, shkretoret, rafineritë ose të depozituar);

e) sasinë e mineralit të shitur te konsumat orët gjatë muajit kalendarik, emrat dhe adresat e blerësve dhe kontratat e shitjes, të cilat duhet të përmbajnë veçoritë mbi natyrën, cilësinë dhe përmbajtjen e mineraleve;

f) emrat dhe vendndodhjet e fabrikave të pasurimit, shkretoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali;

g) koston për ton të fabrikës së pasurimit, shkretoreve dhe rafinerive ku është shpërndarë minerali gjatë muajit kalendarik;

h) koston për ton të transportit të mineralit të shitur gjatë muajit kalendarik e detajuar kjo në rastin kur transporti i mineralit kryhet duke kaluar në disa hallka transporti;

i) shpenzimet e shitjes nëse ka dhe që janë kryer gjatë muajit kalendarik;

j) një llogaritje të detajuar të rentës së pasurisë minerare gjatë muajit kalendarik.

Zotëruesi i lejes së shfrytëzimit duhet të mbajë pranë minierës librat përkatës të prodhimit të mineralit nga zona e lejuar dhe të gjithë dokumentacionin që lidhet me to. Të gjitha të dhënat mbi prodhimin, transportin, përpunimin dhe shitjen, përfshirë këtu dhe kontratat e shitjes, kontrollohen nga degët e tatimeve dhe doganave.

Pagesa e rentës minerare do të kryhet nga subjektet e pajisura me leje shfrytëzimi minerale, pranë organeve tatimore.

2.4.4 Kur organet doganore apo tatimore konstatojnë shmangie të dukshme të vlerës së mineralit apo nënproduktit minerar të deklaruar nga subjekti me vlerën e tregut, ato do t'u referohen vlerës së tregut për llogaritjen e rentës minerare.

Vlera e tregut për këtë kategori mineralesh apo nënproduktesh, sipas përcaktimit të pikës 7 të vendimit e Këshillit të Ministrave nr.1203, datë 27.8.2008, do të nxirret nga një komision i përbërë nga specialistë të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore. Vlera e tregut, e përcaktuar nga ky komision, më pas do të dërgohen për miratim pranë komisionit ad-hoc, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

Si burim informacioni për krijimin e dosjes me të dhënat e disponueshme për vlerën e eksporteve minerare shërbejnë burime, të tilla: si çmimet e tregjeve ndërkombëtare, të dhënat statistikore të Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, investigimi i tregut, brenda dhe jashtë vendit, kryer nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Agjencia Kombëtare e

Burimeve Natyrore, çmimet e produkteve minerare, të ngjashme, që eksportohen, çmimet e paraqitura në deklaratën e eksportit, për subjektet e tjera, që veprojnë në të njëjtën industri.

Në këto raste, degët doganore dhe tatimore, për llogaritjen e rentës minerare të produkteve minerare apo nënprodukteve, bazuar në vlerat e tregut, do t'u referohen vetëm çmimeve të dërguara nga komisioni ad-hoc, krijuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.686, datë 2.11.2005.

2.5. Taksa e akteve dhe e pullës

Shtetasit për çdo dokument të lëshuar nga zyrat e gjëndjes civile janë të detyruar të paguajnë taksën sipas lidhjes Nr. 3 të ligjit. Dokumentat e gjëndjes civile janë të vlefshme vetëm kur kanë pullën e taksës të vulosur me vulën e gjëndjes civile.

Vjelja e taksës për kartën e identitetit bëhet me mandat arkëtimi.

Derdhja e taksave të vjelura në llogarinë e organit tatimor do të bëhet jo më vonë se 5 ditë nga data e arkëtimit.

Pika 2.6 shfuqizohet

2.7. Taksa për ushtrimin e veprimtarisë së peshkimit

Kjo taksë është vjetore dhe me vjeljen e saj ngarkohet Drejtoria e Politikave të Peshkimit në Ministrinë përgjegjëse për ujërat. Pagesat e kësaj takse bëhen sipas lidhjes Nr.4 të ligjit. Detyrimi për pagimin e kësaj takse lind në momentin e marrjes së lejes për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit.

Lejet për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit jepen mbasi të jetë paguar taksa përkatëse. Kjo taksë derdhet në llogarinë e Drejtorive Rajonale të tatimeve brenda 5 ditësh nga momenti i arkëtimit.

2.8 Taksa e ambalazheve njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit

2.8.1. Në zbatim të neneve 3, 4, 5 dhe 8 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, taksa e ambalazheve një përdorimësh të plastikës dhe të qelqit aplikohet për produktet e përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012. Niveli i taksës së ambalazheve një përdorimësh të plastikës është 100 lekë/kg, niveli i taksës së ambalazheve njëpërdorimësh të qelqit është 10 lekë/kg, ndërsa vetëm për industrinë vendase të riciklimit, taksa për ambalazhet e prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, është 50 lekë/kg. Taksa e ambalazheve njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit aplikohet si në import, ashtu edhe në prodhimin vendas.

Për ambalazhet njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit të importuara, importuesi e paguan taksën pranë degëve doganore ku është duke kryer procedurat e zhdoganimit. Për ambalazhet njëpërdorimësh të plastikës dhe të qelqit të prodhuara brenda vendit, prodhuesi paguan në bankën e nivelit të dytë për llogari të drejtorisë rajonale ku është regjistruar, taksën për të gjithë sasinë e prodhuar, brenda datës 5 të muajit pasardhës. Prodhuesi duhet të plotësojë e të dorëzojë në drejtorinë rajonale tatimore ku është regjistruar, formularin nr.1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke deklaruar sasinë e prodhuar dhe duke i bashkëlidhur mandatpagesën për taksën e paguar.

2.8.2. Për qëllim të këtij udhëzimi dhe në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

a) “Ambalazh” është çdo material pakëtues që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund të mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë. Ai e mbron atë nga ndotja, infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe e bën të

përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.

b) “Ambalazh njëpërdorimësh”, për qëllime të këtij udhëzimi, do të konsiderohen ato ambalazhe që nuk i nënshtrohen regjimit të lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë sipas nenit 161 të ligjit nr. 8449 datë 27.1.1999 “Për Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë” dhe pikave 3 dhe 4 të nenit 349 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.4.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.

c) “Ambalazh plastik njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të germës “b” më lart, dhe që klasifikohen në kodet tarifore 3923 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohet veçmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012 dhe zë të paktën 51% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

ç) “Ambalazh qelqi njëpërdorimësh” janë ambalazhet njëpërdorimëshe sipas përkufizimit të germës “b” më lart dhe që klasifikohen në kodin tarifor 7010 dhe 392410 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave në rastet kur importohet veçmas, dhe ambalazhet që ruajnë apo paketojnë mallrat e listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 të ligjit 83/2012 dhe zë të paktën 80% të masës së përgjithshme të ambalazhit.

d) “TAN”, në kuptim të këtij udhëzimi, është shkurtimi i taksës së ambalazhit njëpërdorimësh.

2.8.3.Importuesi duhet të marrë masa që, vetë apo nëpërmjet kompanisë prodhuese apo eksportuese, të bëjë ndarjen e llojeve të ambalazhit të produkteve të importuara, për qëllimet e aplikimit të TAN. Në rast se nga ndarja rezulton që produktet përbërëse të ambalazhit sipas përkufizimit kategorizohen në germat “c” apo “ç”, atëherë importuesi është i detyruar të deklarojë TAN-in në deklarin e tij dhe ta paguajë atë. Deklarimi i ambalazhit në DAV në import bëhet në nivel artikulli. Kur për të njëjtin artikull ka ambalazhe të ndryshme sipas kategorizimit të mësipërm, detyrimisht në DAV do të bëhet deklarimi i ndarë (me BIS) për artikujt me kod tarifor të njëjtë, por me kodifikim të ndryshëm ambalazhi në kutinë 31 të DAV.

2.8.4 Në rastet e importimit të ambalazheve njëpërdorimëshe të përdorur për importimin e produkteve të tabelave 2 të anekseve 1 dhe 2 të ligjit, nga pesha bruto përjashtohen paletat e drurit, të kartonit apo metalike.

Shembuj.

a) Në rast se në import paraqitet ambalazh plastik sipas kodeve tarifore të tabelës 1 të aneksit 1 të ligjit dhe plotësohen kushtet e germës “b” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg.

b) Në rast se në import paraqiten mallra në ambalazh qelqi sipas kodeve tariforë të tabelës 1 të aneksit 2 të ligjit dhe plotësohen kriteret e germës “c” të pikës 1 të këtij udhëzimi, TAN zbatohet në bazë të peshës neto duke aplikuar nivel taksimi 10 lekë/kg.

c) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 1 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit, dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 100 lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

ç) Në rast se në import paraqiten mallra të klasifikuara në kodet tarifore të tabelës 2 të aneksit 2 të ligjit, në kutinë 31 të DAV përdoret kodi përkatës i paketimit, dhe TAN zbatohet mbi diferencën e peshës bruto me atë neto, duke aplikuar nivel taksimi 10

lekë/kg. Në kutinë 38 të DAV si peshe neto plotësohet pesha e produktit të konsumueshëm pa asnjë lloj ambalazhi.

d) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 1 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 1 të aneksit 2 të ligjit (pra ka edhe ambalazh plastik bosh edhe ambalazh qelqi bosh), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS); sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas peshës neto përkatëse.

e) Në rast se në import, në të njëjtën ngarkesë, paraqiten mallra që janë edhe në tabelën 2 të aneksit 1 të ligjit, edhe në tabelën 2 të aneksit 2 të ligjit (p.sh. vaj vegjetal të kodeve 1507-1518 të ambalazhuara një pjesë në shishe plastike dhe një pjesë në shishe qelqi), atëherë DAV plotësohet në nivel artikulli (pra me BIS), duke përdorur kode të ndryshme paketimi për sasi të respektive; sistemi llogarit nivelin e taksës për çdo artikull sipas diferencës së peshës bruto me atë neto për çdo artikull.

f) Në rast se në import paraqiten mallra të ndryshëm nga kodet tarifore të listuara në tabelën e dytë të aneksit 1 dhe nga tabelën e dytë e aneksit 2 të ligjit 83/2012, por të ambalazhuara në ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi (p.sh. medikamente të kapitullit 30 të NK në ambalazh qelqi), atëherë për këto mallra nuk aplikohet TAN.

2.8.5 Për mallrat me ambalazhe njëpërdorimëshe plastike apo qelqi, të prodhuara në vend, TAN do të paguhet në momentin e shitjes së mallrave, me faturë tatimore. Për efekt pagese, subjekti prodhues do të ndajë në faturën tatimore çdo shitje të mallrave sipas kapacitetit mbajtës të ambalazhit.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, furnizohen nga subjekte që importojnë apo prodhojnë këto ambalazhe, kërkojnë nga prodhuesi apo importuesi, krahas faturës tatimore, dhe pagesën e TAN në organet tatimore apo doganore.

Në rastet kur personat juridikë apo fizikë, prodhues të mallrave që kërkojnë ambalazh njëpërdorimësh plastik apo qelqi, e prodhojnë vetë ambalazhin dhe e shesin atë për të tretë, do të paguajnë TAN për sasinë e shitur me faturë tatimore.

Çdo person juridik apo fizik, prodhues i ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, boshe për prodhimin e vet, si dhe çdo importues apo prodhues i ambalazheve boshe, në fund të çdo muaji do të deklarojnë stokun në organin tatimor ku është i regjistruar. Në rast të kundërt organet tatimore do të llogarisin TAN-in e këtyre ambalazheve për të gjitha shitjet e kryera për çdo muaj.

Në rastet e importimit të produkteve gjysmë të gatshme që përkrijnë sipas kodeve të NK të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, të cilat janë qartësisht të destinuara për prodhimin e ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës apo qelqit të përcaktuara në anekset 1 dhe 2 të ligjit nr. 83/2012, TAN paguhet në momentin e importimit, pavarësisht nëse importuesi është prodhues vendas dhe i importon këto produkte në funksion të aktivitetit të vet prodhues apo është importues i këtyre produkteve për qëllime tregtare.

2.8.6. Të gjitha subjektet prodhuese të ambalazheve njëpërdorimëshe të plastikës dhe të qelqit, brenda datës 30 tetor 2012 duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale ku janë regjistruar, këto dokumente:

a) Licencë/leje/miratim nga institucioni përkatës, për prodhimin e produkteve njëpërdorimëshe të plastikës dhe qelqit;

b) Kopje të kartës teknologjike të prodhimit.

Çdo ndryshim i kartës teknologjike duhet t'i njoftohet organit tatimor një muaj përpara.

2.8.7 Taksa për ambalazhet të prodhuara nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në vend, caktohet në masën 50 lekë/kg. Kjo taksë mbledhet nga

administrata tatimore, në rastet kur mallrat sipas aneksit 1 të ligjit nr. 83/2012, paketohen, ruhen apo ambalazhohen me ambalazh plastik të prodhuar nga riciklimi i mbetjeve plastike të gjeneruara në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Subjektet prodhuese të këtyre ambalazheve duhet të paraqesin pranë drejtorisë rajonale tatimore ku janë të regjistruar kopje të kartës teknologjike të certifikuar nga një institut/laborator i njohur. Në fund të çdo muaji, këto subjekte duhet të paraqesin kopje të deklaratave të importimit të lëndëve të para, si dhe dokumentimin e blerjeve të lëndëve të para brenda vendit. Administrata tatimore është përgjegjëse për monitorimin e lëndëve të prodhuara nga riciklimi për qëllime përdorimi të ambalazheve.

2.8.8. Të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë paguar pranë administratës doganore, akcizë për ambalazhet e plastikës dhe të qelqit sipas ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar dhe kanë qenë të pajisur me autorizim si tatimpagues akcize dhe kanë pasur magazinë tatimore, në rast të shitjes së produktit (për të cilin është paguar akcizë në import) pas datës 1 tetor 2012 nuk janë subjekt i pagesës së TAN-it. Këta tatimpagues duhet që brenda datës 15 tetor 2012 të paraqesin pranë drejtorive rajonale ku janë të regjistruar, kopje të inventarit të ambalazheve për të cilat është paguar akciza. Administrata tatimore në bashkëpunim me administratën doganore kryejnë verifikimet rast pas rasti.

3. Përfashtime nga taksat kombëtare

3.1. Përfashtohen nga pagimi i taksës vjetore të mjeteve të përdorura:

a) mjetet në pronësi të ambasadave dhe organizatave ndërkombëtare, që gëzojnë status diplomatik, të akredituara në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimin e reciprocitetit;

b) personat fizikë ose juridikë, të cilët deklarojnë, brenda muajit janar të vitit në vazhdim, se nuk do të qarkullojnë me mjetet në pronësi të tyre gjatë këtij viti kalendarik, ose do të dalin përfundimisht nga qarkullimi dhe dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit;

b.1) pagesat e taksës së mjeteve të bllokuara me vendim të gjykatës, prokurorisë etj., për periudhën në të cilën mjeti ka qenë i bllokuar.

c) autoveturat tip 4+1 vende dhe me cilindrata jo më shumë se 2500 kubikë, kur këto mjete kalojnë në zotërim të invalidëve e të veteranëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar, invalidëve të punës, të verbërve, invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë që e fitojnë këtë status në bazë të ligjeve përkatëse dhe përdoren vetëm për nevojat e tyre personale dhe jo për veprimtari private.

Përfashtimi nga pagimi i taksës bëhet vetëm kur veprimet bëhen në emër të veteranit të luftës, invalidit të punës a të luftës, të verbrit, të sëmurëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Veterani i luftës, invalidi i luftës apo i punës, personat e verbër, si dhe të sëmurët paraplegjikë dhe tetraplegjikë duhet të paraqesin pranë agjentit tatimor librezën përkatëse, së bashku me dokumentin e identifikimit të personit që përfiton përfashtimin nga taksa dhe vërtetimin që nuk kryen veprimtari ekonomike.

d) makinat bujqësore.

3.2 SHFUQIZOHET

3.3. Përfashtohen nga pagimi i taksës së akteve dhe pullës:

a) veprimet zyrtare, që kërkohen nga autoritetet e huaja, në bazë të reciprocitetit;

b) regjistrimi i lindjeve dhe i vdekjeve, si dhe shënimet në regjistrat e gjendjes civile.

4. Të gjitha përjashtimet do të shënohen në një regjistër të veçantë ku do të jetë shënuar emri, mbiemri, si dhe ekstremet e librezës sipas formularit Nr.6, bashkëngjitur këtij udhëzimi.

4. Tarifat e shërbimit.

Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare” nivelet e tarifave të shërbimit, për tarifat të cilat arkëtohen nga organet tatimore dhe doganore, do të përcaktohen me Udhëzim të Ministrit të Financave, ndërsa tarifat të cilat mbliidhen nga institucionet e tjera, do të përcaktohen me Udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe titullarit të institucioneve respektive.

4.1. Personat që gëzojnë statusin e invalidit, në bazë të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, statusin e invalidit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7663, datë 20.1.1993 “Për statusin e invalidit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, statusin e veteranit të luftës, në bazë të ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, të ndryshuar, apo statusin e të verbërit, në bazë të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të verbërit”, përjashtohen nga:

- a) tarifa për shërbimet konsullore e Ministrisë së Punëve të Jashtme apo e ambasadave tona jashtë vendit;
- b) tarifa për përdorimin e aparateve televizive e Radiotelevizionit Publik;
- c) tarifa për pajisjen me pasaportë lundrimi e Kapitenerisë së Porteve;
- ç) tarifa e pajisjes me leje drejtimi e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

2. Personat e sipërpërmendur nuk i përfitojnë këto përjashtime nëse kryejnë veprimtari private si persona fizikë apo juridikë.

5. Zbatimi i Udhëzimit

Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, degët e tyre si dhe Agjentët përkatës.

5. Shfuqizime

Udhëzimi Nr.1, datë 30.01.2006 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”, shfuqizohet.

6. Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në fletoren zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi më 1 tetor 2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

*** Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 26/1, dt. 20.11.2008. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 174, dt. 20.11.2008

*** Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 25, dt. 19.7.2010. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 94, dt. 22 korrik 2010

*** Ndryshuar me Udhëzimin Nr.18, date 23.8.2011. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 120, date 24 gusht 2011.

*** Ndryshuar me Udhëzimin Nr. 21, date 1.10.2012. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 127, date 1.10.2012

Formulari Nr.1

REGJISTRI DITOR I TAKSES VJETORE TE MJETEV TË PËRDORURA
PER VITIN _____ Muaji _____

Nr	Numri i		Data	Emri, mbiemri i pronarit	Targa	Lloji i mjetit	Vlera e takses (ne leke)	Numri i grupimit te mjetit (sipas fatures)
	Fatures	M.arket						

Drejtoria Rajonale e Transportit Rrugor

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT
(per llogaritjen e takses se qarkullimit)

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar _____

NIPT-i _____

Adresa : _____

Nr. Telefonit _____

Nr.	Lloji i lendes djegese per muajin _____	Njesia	Periudha 5 ditore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa per njesi	Detyrim leke per tu paga
			Nga data ____/____	ne daten ____/____			
A	b	c	d	E	1	2	3=(1x2)
1	Benzine	litër					
2	Gazoil	litër					

Subjekti deklarues

(Emer Mbiemer firme)

Data e deklarimit

____/____/____

201____

Shenim

:

Kjo tabele dorezohet nga subjekti tatimpagues prodhues ne drejtorine rajonale tatimore ku eshte i regjistruar subjekti tatimpagues (ne sektorin e vleresimit) cdo 5 dite shoqeruar me dokumentin e pageses.

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT
(Per llogaritjen e takses se karbonit)

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar _____

NIPT-i _____

Adresa

: _____

Nr. Telefonit

Nr.	Lloji i lendes djegese per muajin _____	Njesia	Periudha 5 ditore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa per njesi	Detyri leke per t pagua
			Nga data ____/____	ne daten ____/____			
A	b	c	d	e	1	2	3= (1x
1	Benzine	litër				1,5	
2	Gazoil	litër				3	
3	Solar	litër				3	
4	Mazut	litër				3	
5	Koks nafte	Kg				3	
6	Qymyr	Kg				3	

Subjekti deklarues

(Emer Mbiemer firme)

Data e
deklarimit

_____/____/

201____

Shenim

Kjo tabelë dorezohet nga subjekti tatimpagues prodhues në drejtorinë rajonale tatimore ku është i regjistruar subjekti tatimpagues (në sektorin e vlerësimit) çdo 5 ditë shoqëruar me dokumentin e pagesës.

Formulari Nr.4

TABELA DEKLARUESE E PRODHIMIT

(Per llogaritjen e takses së ambalazheve një
përdorimësh të plastikës dhe të qelqit(TAN))

Emri tregtar i subjekti prodhues shqiptar _____

NIPT-i _____

Adresa : _____

Nr. Telefonit _____

Nr.	Lloji i ambalazhit të prodhuar per muajin _____	Njesia	Periudha mujore e prodhimit		Sasia e prodhuar	Taksa per njesi	Detyrimi leke per tu paguar
			Nga data ____/____	ne daten ____/____			
			d	e			
a	b	c	d	e	1	2	3= (1x2)
1		Kg					
2		Kg					
3		Kg					
4		kg					
5		Kg					
6		Kg					

Subjekti deklarues
(Emer Mbiemer firme)

Data e deklarimit
____/____/ 201____

Shenim :

Kjo table dorezohet nga tatimpaguesi prodhues brenda dates 5 te muajit pasardhes, ne drejtorine rajonale tatimore ku eshte i regjistruar, shoqeruar me dokumentin e pageses. Formulari plotesohet ne dy kopje. Nje kopje e mban Drejtoria Rajonale Tatimore dhe kopjen tjeter tatimpaguesi